


“Në kërkim të trajektores Celano Foggia” “LOOKING FOR ... TRATTURO CELANO FOGGIA”

Workshop ndërkombëtar në urbanistikë, për rigjenerimin e pejsazheve të trajektores-Tratturo përgjatë Komunave: Celano, Aielli, Cerchio, Collarmele, Pescina, Castelvechio Subequo, Castel di Ieri, Goriano Siculi, Raiano, Prezza, Pratola Peligna, Sulmona, Pettorano sul Gizio, Rocca Pia, Rivisondoli, Roccaraso/

3 - 8 Ottobre/October 2021



PREZANTIM

Workshopi ndërkombëtar **Alla ricerca del Tratturo Magno/LOOKING FOR ... TRATTURO CELANO FOGGIA**, fillon në 4 Tetor 2021, me Seminarin e parë prezantues pranë Departamentit të Arkitekturës në Pescara.

Programi parashikon zhvillimin e 4 etapave hulumtimi përgjatë fragmentit Abruzes të trajektores (Tratturo) që ndiqnin barinjtë gjatë spostimit të bagëtive nga një vend në tjetrin. Ky fenomen migrativ i njohur si *Transumanza*, bëhej përgjatë një trajektore e cila që prej vitit 2019, është

përfshirë nga UNESCO, në listën e pasurive kulturore jomateriale. Këto 4 etapa do të përfshijnë Komunitat Celano, Collarmele, Pratola Peligna, Pettorano sul Gizio e Rocca Pia.

Në program do të përfshihen edhe disa inisiativa të *pjesëmarrjes dhe angazhimit publik*, siç janë Seminari publik “TË TREGOSH KUJDES PËR PASURITË E PËRBASHKËTA TERRITORIALE” i mbajtur në dt. 5 Tetor ora 15.00-18.00 pranë qendrës kulturore E.De Filippo të Collarmele, si dhe Seminari përfundimtar i prezantimit të rezultateve të workshopit, të premten 8 Tetor, ora 17.00-19.00 pranë Selisë së Komunes Rocca Pia.

Workshopi **Në kërkim të trajektores /LOOKING FOR ... TRATTURO CELANO FOGGIA**, është një aktivitet internacional i lindur si një bashkëpunim midis 3 Universiteteve: Dipartimento di Architettura në Pescara, Facoltà di Scienze dell’Habitat në Bogotá, Facoltà di Architettura e Urbanistica në Tiranë, dhe zhvillohet me një metodologji mikse, me prezencë dhe online, nga 3-8 tetor 2021 por edhe në formë të një workshopi shëtitës, *në ajër të pastër*, përgjatë fragmentit Abrucez të Trajektores, Celano-Foggia.

Kjo inisiativë së pari i propozon studentëve një udhëtim hulumtues në territor, i cili bëhet njëkohësisht edhe një kërkim në zbulim të trajektoreve, vëndeve, hapësirave, pejsazheve, vlerave territoriale të lidhura me komunitetin migrator të *Transumanza-s*, një zakon që prej shumë shekujsh ka lënë gjurmë dhe ndërtuar pejsazhet e brendshme të Italisë qëndrore e jugore.

Një hulumtim i tillë do të ketë si fill drejtues kërkimin dhe paraqitjen nëpërmjet hartave, të trajektores dhe terreneve të lidhura me të. Rizbulimi dhe përshkrimi i kësaj trajektore, në fillim në harta e më pas, përmes materialeve të ndryshme, në territoret reale në të cilat kalonte, do të jetë një rast për të monitoruar kushtet aktuale të kësaj pasurie, të gjendjes në të cilën ndodhet, të funksioneve kryesore që luan aktualisht dhe të potencialeve që paraqet për të ardhmen, por edhe për të përpunuar skenare e propozime projektuese të cilat do ti jepnin kësaj pasurie kulturore dhe tokave ku shtrihet, kushtet e një **të mire të përbashkët territoriale**, e të një hapësire dhe burimi komunitar për të rilindur zakone e praktika të mira ekonomike.

Në kërkim të trajektores /LOOKING FOR ... TRATTURO është kështu edhe një laborator urbanistike përfshirës dhe krijues projektesh dhe aksionesh të tipit *Tactical Urbanism* për rigjenerimin e pejsazheve natyralë në komunitat Abruzzese ku kalon kjo trajektore: Celano, Aielli, Cerchio, Collarmele, Pescina, Castelvechio Subequo, Castel di Ieri, Goriano Siculi, Raiano, Prezza, Pratola Peligna, Sulmona, Pettorano sul Gizio, Rocca Pia, Ravisoldoli, Roccaraso.

Një nga qëllimet kryesore të workshopit është që të zgjojë interesin mbi kushtet aktuale të Trajektores-Tratturo, edhe nëpërmjet prodhimit të hartave dhe materialeve video e grafike, të cilat ndërgjegjësojnë në lidhje me kushtet aktuale të një “pasurie të përbashkët” dhe të gjithë të mirave pejsazhistike dhe territoriale të lidhura me të. Kështu workshopi është në përputhje me objektivin 11.7 të Axhendës ONU 2030. Sipas këtij objektiivi 11.7: deri në vitin 2030 duhet që të sigurohet aksesueshmëria në hapësirat publike e të gjelbërta, të cilat duhet të jenë të shëndetshme, të pastra, përfshirëse dhe të arritshme, në vecanti për gratë e fëmijët, për personat në moshë të thyer si dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Dipartimento di Architettura, Università degli Studi di Chieti e Pescara, Italia
Facultad Ciencias del Habitat, Universidad La Salle, Bogotá, Colombia
Department of Architecture and Urbanism, Polytechnic University of Tirana, Albania

Kështu kjo aksesueshmëri u kthye në motiv të përpunimit të një harte të hapur (Open Map), të titulluar: “Trajektorja Celano Foggia / harta e kalueshmërisë në fragmentin Celano Rocca Pia”. Tashmë këtë hartë “Tratturo Celano Foggia. Carta della percorribilità, tratto Celano Rocca Pia”, të gatshme por dhe në proces përpunimi, e gjejmë në linkun:

<https://www.google.com/maps/d/edit?mid=1MO3y-LEb7h4y7NuvFOzkFv6OPrfoNGWm&usp=sharing>

Rezultate të mëtjeshme të pritshme i përkasin ndërtimit të një database të hapur, në modalitetin OpenData, të materialeve kërkimore para dhe pas workshopit, e cila do të vendoset online në bashkëpunim me administratat lokale të komunave dhe universitetet e përfshira. Njëkohësisht do të arrihet të jepen ide zhvillimi të disa zonave pilot të identifikuara përgjatë trajektores së Tratturo-s, duke vazhduar kështu studimet e filluara tashmë edhe në fushën didaktike e administrative (tema diplomash e projekte të inisiativës publike).

Projekti shkencor didaktik dhe profesori përgjegjës:

Piero Rovigatti, Osservatorio Tratturi Bene Comune, DdA, E-Mail: p.rovigatti@unich.it, cell.: + 39 333 492 1762

Università degli Studi G. d’Annunzio dell’Adriatico, Chieti e Pescara

Settore scientifico disciplinare di riferimento: **ICAR 21 Urbanistica**

Profesorë të përfshirë nga universitete Italiane dhe të huaja.

Freddy Diaz Diaz, Universidad de La Salle, Bogotá

Carlos Aguelo, Universidad de La Salle, Bogotá

Armand Vokshi, Università Politecnica di Tirana

Loreta Çapeli, Università Politecnica di Tirana

Florian Nepravishta, Università Politecnica di Tirana

Jonida Meniku, Università Politecnica di Tirana

Lina Calandra, Dipartimento di Scienze Umane, Università degli Studi di L’Aquila

Ottavia Aristone, Dipartimento di Architettura, Università degli Studi di Chieti Pescara

Piero Rovigatti, Dipartimento di Architettura, Università degli Studi di Chieti Pescara

Kordinimi teknik e shkencor: **Ludovica Simionato**, e-mail: ludovica.simionato.95@gmail.com